



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2021



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

Më 26.01.2021

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Halim Shehu Komandant i Policisë-Kaçanik

Përfaqësuesi i FSK-së

Remzi Reka, OMM „Gjethi”

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtore i Shërbimeve Publike dhe Emergjence

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu-Bashkësia Islame

Zahir Doda-Drejtore i DAK

Me arsyetim munguan: Fadil Guri dhe Vedat Dema

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore
4. Informatë e shtabit emergjent mbi situatën me pandeminë në komunën tonë
5. Informatë rreth punës së inspektorëve komunal
4. Të ndryshme

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës **Komandanti i Policisë** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Gjatë kësaj periudhe kohore nga mbledhja e kaluar e deri më sot i kemi të evidentuar gjithsej 71 raste që kanë prishur rendin dhe sigurinë publike .

Kanë ndodhur gjithsej 25 raste të vjedhjeve të rënda , 12 raste vjedhje e rëndomtë , armëmbajtje pa leje -2 raste , falsifikim i parasë-4 raste , kanosje -3 raste , dhunë në familje -4 raste , keqpërdorim i besueshmërisë – 2 raste shkaktim i rrezikut të përgjithshëm -1 rast , ndërsa rastet tjera kanë qenë incidente .

Sa i përket zbulueshmërisë së rasteve në këtë periudhë kohore është bërë një punë e mirë , ku gjithsej janë zbuluar 14 raste, 8 persona janë arrestuar dhe me urdhër të prokurorit janë dërguar në mbajtje prej 1 muaji e që vepra e tyre ka të bëjë me dukurinë e vjedhjeve. Personat kanë pranuar fajësinë për veprat e kryera dhe jemi në proces të zbulimit të rasteve të tjera. Të dyshuarit e kapur janë të gjithë nga komuna e jonë dhe vetëm një është nga fshati Komogllavë i komunës së Ferizajt.

Vlen të theksohet se nuk kemi pasur informata të mjaftueshme nga qytetarët gjë e cila na e ka vështirësuar punën tonë në kapjen e keqbërësve.

Lidhur me një rrahje që ka ndodhur muaj më parë, dy persona janë në paraburgim ndërsa gjendja e personit të lënduar në këtë rrahje është e mirë.

Nga hetimet që janë bërë rreth rastit të vdekjes së gruaje tek ura e lumit Lepenc në Kaçanik dyshohet që e ndjera ka bërë vetëvrasje. Sa i përket situatës me Pandeminë ne punojmë në bazë të vendimeve që lëshohen nga institucionet përkatëse të nivelit qendrorë. I vetmi ndryshim që është bërë në vendimin e ri është se tubimet publike

në ambientet e mbyllura lejohet deri me 30 persona , ndërsa tubimet e jashtme deri me 50 persona . Kemi pasur informacion se një person ka qenë i infektuar me COVID-19 i cili tashmë është i ndjerë por që nuk kemi pasur asnjë informacion zyrtarë. Gjithsej në vet izolim kanë qenë 1579 persona, 435 raste pozitive dhe raste aktive 46 , ndërsa të vdekur në komunën tonë nga ky virus janë 12 persona.

Kryetari: situata me pandeminë ka qenë një sfidë e që po shpresojmë se me vaksinimin e popullatës po i vjen fundi edhe kësaj pandemie. Për tu brengosur është dukuria e vjedhjeve dhe më gëzon fakti se kohëve të fundit është bërë një punë e mirë në zbulimin e rasteve nga policia e Kosovës.

Lirije Luta: Më intereson të dijë për këta persona që kanë kryer veprat e jashtëligjshme dhe janë në mbajtje prej një muaji, çka procedohet më tutje.

Komandanti i Policisë: Pas një muaji mbajtje këta persona ju nënshtrohen procedurës gjyqësore.

Ramadush Osmani: Dukuria e vjedhjeve ka marrë përmasa të mëdha. Në një rrugë të fshatit Gabrricë janë vjedhur 5 kapak të pusetave, Më intereson të dijë se çfarë masa janë marrë në zbulimin e këtij rasti.

Komandanti i Policisë: jemi të njoftuar rreth këtij rasti dhe kemi hulumtuar në pikat ku shiten hekurishtet por nuk kemi mundur të zbulojmë asgjë.

Fidaim Fazliu: Vjedhjet kanë ndodhur edhe nëpër xhami dhe më gëzon fakti se një person është kapur dhe është nga komuna e Drenasit. Rruga në fshatin Gabrricë tashmë ka sinjalizim për çka falënderojmë komunën që është përkujdesur pas shqetësimit që kam dhënë në takimin e fundit. Vjedhja e kapakëve të pusetave është shqetësuese dhe po paraqet problem në qarkullim të automjeteve dhe mendoj se duhet të intervenohet në sanimin e kësaj gjendjeje .

Remzi Reka: Kisha me i ngritë dy shqetësime : njëri ka të bëjë me rrjetin elektrik të tensionit të lartë në lagjen „2Korriku” , i cili është shumë afër pullazeve të shtëpive dhe shqetësimi tjetër është mungesa e mbrojtësve në rrugën magjistrale Kaçanik – Hani i Elezit .

Kryetari: Rreth problematikës me rrjetin elektrik respektivisht me tensionin e lartë të rrymës elektrike mbi pullazet e shtëpive ne vazhdimisht e kemi ngritë si shqetësim por që ju sugjeroj që ta bëni një kërkesë dhe krahas kësaj kërkesë të bëni edhe një listë me nënshkrime të banorëve të asaj pjese dhe ne si komunë ta kemi si dëshmi për të ju drejtuar kompanisë KEDC . Rruga magjistrale menaxhohet nga niveli qendror dhe mund të themi se nuk kanë shfaqur interesim që të na kontaktojnë për të bërë një zgjidhje edhe pse kanë ndodhur shumë aksidente me fatalitet. Ne, si komunë përsëri do të ngrisim këtë shqetësim për gjetjen e një zgjidhjeje.

Ramadush Osmani: Në rrugën „2 Korriku” janë bërë ndërtime pa leje si para lufte edhe pas saj dhe ky rrjet elektrik ka ekzistuar shumë më herët. Ka qenë dashtë që para se të ndërtohet të kërkohet një leje për ndërtim edhe nga KEDS.

Remzi Reka; Fajtorë janë edhe qytetarët që kanë bërë ndërtime pa leje por faji është edhe tek inspektorët komunal që nuk asistojnë gjatë këtyre ndërtimeve. Me rëndësi që të adresohet problemi dhe t'fshihet për zgjidhjen e këtij problemi.

3. Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore

Në këtë pikë të rendit të ditës fjala iu dha Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencës i cili tha se komuna ka kontraktuar një kompani që mendojmë se i posedon të gjitha mjetet për mirëmbajtjen e rrugëve dhe deri më tani jemi të kënaqur me shërbimet që ofrojnë. Ditë më parë ka pasur vërshime dhe kjo kompani ka arritur që në disa pika kritike të intervenojë dhe të sanojë problemet e paraqitura. Edhe në pastrimin e borës mendoj se ka bërë një punë të mirë ngase me kohë ka dalë në teren dhe ka marrë të gjitha masat për zhbllokimin e rrugëve .

Shemsedin Abazi: Aktualisht ka të reshura të mëdha dhe po më intereson për gjendjen momentale të rrugëve në vendet rurale.

Ramadush Osmani: Inspektorët janë në teren dhe kam informacione se rrugët janë të kalueshme me përjashtim të disa zonave të thella por që po punohet për të sanuar çdo problem që është paraqitur në teren.

Fidaim Fazliu: Rruga Ferizaj – Brezovicë që kalon nëpër është shumë e frekuentuar dhe një pjesë e kësaj rruge shpesh mbetet pa u pastruar nga bora. Është mirë që të bisedohet me komunën e Ferizajt që për një pjesë shumë të vogël të mos mbetet e pa pastruar.

Komandanti i Policisë: janë dy rrugë problematike ku shpesh edhe po detyrohem të lëshojmë gjoba. Rruga „Qamil Ilazi” dhe rruga „Vëllezërit Çaka” janë të mbingarkuara me biznese të cilët mallin e tyre po e ekspozojnë nëpër trotuare . Në këtë rast kërkoj nga inspektorët komunal asistencën tonë me qëllim të pengimit të kësaj dukurie.

Kryetari: Besoj se nga shkurti i këtij viti inspektorët komunal do të kalojnë në zyrën e Kryetarit ku do të kemi edhe një kryeinspektor dhe punët do të shkojnë më mirë

Fidaim Fazliu: Shpesh e kemi diskutuar një problematikë në lidhje me sinjalizimin në fushën e pajtimit. Policia rregullisht qëndrojnë aty dhe po japin shumë gjoba. Po më intereson se a ka sinjalizim të mirëfilltë në këtë pjesë.

Ramadush Osmani: Sa i përket rrugës Ferizaj- Brezovicë kompanitë i kanë të kontraktuar rrugët për mirëmbajtje dhe nuk mund të faturojnë fatura për pjesën që nuk e kanë me kontratë. Me marrëveshje mund edhe të bëhet por që nuk e kanë obligative. Problemin e sinjalizimit të Fushës së Pajtimit e kemi ngritë edhe në nivelin qendror dhe në një takim që kemi pasur më kanë bindë se sinjalizimi është në nivel të duhur. I vetmi opsion është që të bëhet një rreth rrotullim në këtë pjesë.

Kryetari: edhe unë mendoj se sinjalizimi në këtë pjesë nuk është si duhet por që duhet respektuar ai që është .

Komandanti i Policisë: Ne mund të japim propozime për të ndryshuar por që është nën kompetencën e nivelit qendrorë dhe ne duhet ta respektojmë.

Remzi Reka: U tha që policia është duke dhënë gjoba në trafik e sidomos për parkingje ilegale . unë mendoj se ligji duhet të funksionojë për të gjithë njësoj dhe qytetarët duhet të vetëdijesohen njëherë e përgjithmonë në respektimin e rregullave në trafik. Sa i përket pjesës të Fusha e Pajtimit edhe unë mendoj që sinjalizimi nuk është i përshtatshëm e sidomos në dalje të autostradës që lidhet me rrugën regjionale .

Komandanti i Policisë: Në kuadër të stacionit të policisë kemi një komision për shqyrtim të ankesave nga qytetarët. Ankesat shqyrtohen dhe përgjigja iu kthehet qytetarëve por që shumë herë kemi ankesa të pa arsyeshme.

4. Informatë e shtabit emergjent mbi situatën me pandeminë në komunën tonë

Kryetari: Para vetes e keni një raport që këshilli emergjent për situatën me pandeminë ka bërë edhe për Kuvendin Komunal, ne si Komunë kemi qenë më pak të goditur nga kjo pandemi në krahasim me komunat tjera. Të dhënat tona ndryshojnë pak nga ato të policisë por që këto të dhëna nuk po na përcillen me kohë nga niveli qendrorë. Sipas të dhënave tona gjithsej janë 345 raste me COVID-19, 299 janë të shëruar, 35 janë aktiv dhe 11 janë të vdekur. Situatën e kemi menaxhuar mirë falë bashkëpunimit që kemi pasur me të gjithë akterët. Po shpresojmë që kësaj pandemie së shpejti do i vjen fundi ngase ka filluar vaksinimi në shumë vende të botës. Teste për COVID-19 ka të mjaftueshme dhe secili qytetarë që ka simptoma mundë ta bëjë këtë test.

Remzi Reka: Është e vërtetë se në krahasim me disa vende të rajonit Kosova qëndron mirë sa i përket situatës me pandeminë por që kohëve të fundit sikur jemi liruar pak si shumë duke mos ju përmbajtur masave e që mund edhe të pësojmë. Policia dhe inspektorët komunal të kryejnë detyrën dhe mos të tolerohet askush që nuk zbaton masat anti-covid. Kemi hyrë në një situatë të zgjedhjeve dhe partitë politike nuk po i respektojnë masat e vendosura nga IKSH.

5. Informatë rreth punës së inspektorëve komunal

Kryetari: këtë pikë të rendit të ditës mund ta trajtojmë në mbledhjen e radhës ngase inspektorët komunal nga muaji shkurt kalojnë në zyrën e Kryetarit ku do ta kemi edhe një Kryeinspektor dhe punët do shkojnë më mirë.

Të ndryshme

Remzi Reka: në mbledhjen e radhës të shqyrtohen rekomandimet e dalura nga viti 2020 dhe për çdo rekomandim të diskutojmë se a është zbatuar dhe a është arritur diçka .

REKOMANDIMET:

- 1.Të rritet bashkëpunimi i akterëve të sigurisë dhe qytetarëve në parandalimin e dukurive negative,**
- 2.Institucionet e nivelit qendror të jenë më të përpiktë në dhënien e informacioneve për personat e infektuar me COVID-19,**
- 3.Të punohet më shumë rreth sinjalizimit të rrugëve,**
- 4.Të bisedohet me nivelin qendrorë për vendosjen e mburojave në rrugën magjistrale Kaçanik-Hani Elezit,**
- 5.KEDS të jenë më aktiv në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në lidhje me rrjetin elektrik,**
- 6.Inspektorët komunal të jenë më aktiv në ruajtjen e sigurisë publike si dhe të asistojnë në parandalimin e ndërtimeve pa leje,**
- 7. Të zbatohet ligji për të gjithë ata që shkelin rregullat në trafik dhe për ata që nuk respektojnë masat e sigurisë të vendosura nga IKSHP,**
- 8. Rekomandimet e dalura nga KKSB për vitin 2020 të shqyrtohen dhe të punohet në zbatim të këtyre rekomandimeve.**

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi

Procesmbajtës:

Fatmir Qaka
